



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:055063

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743299

P.nr.72/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me sekretaren juridike Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve A.B dhe L.M, të akuzuar për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr.20/2023 të datës 28.02.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën prokurorisë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë e parashtruar me datë 14.05.2024, për dhënien e urdhrin ndëshkimor – dënim me gjobë, andaj gjykata konform nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP), jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

- A.B** i lindur me dt.... në I., nga i ati N. dhe e ëma Sh. e vajzërisë Z., me vendbanim ne rr. "Diturija" fsh S. K. I, ka të kryer shkollën fillore, me profesion puntor krahu, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët financiare, i nacionalitetit egjiptas, shtetas i Republikës Kosovës.
- L.M** e lindur me dt.... ne G., nga i ati Z. dhe e ëma Gj. e vajzërisë C., me vendbanim ne rr."Diturija" fsh. S. K. Istog, ka te kryer shkollën fillore, amvise, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së dobët financiare, e identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me numër personal ,.... e nacionalitetit egjiptas, shtetase e Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me dt.30.11.2022, rreth orës 16:40 minuta, në shtëpinë e tyre në fsh Serbobran K e Istogut me dashje dhe në bashkëkryerje kanë përdorur forcën ndaj të dëmtuarës A.Z në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të çastit në mes të te dëmtuarës dhe të pandehurve, lidhur me faktin se e pandehura Lauresha e kishte përdorë Facebookun e bashkëshortit të dëmtuarës Adelina, ku si pasoj e kësaj fillimisht fillon një zënkë ku e pandehura Lauresha e kapë të dëmtuarën për flokë ndërsa i pandehuri A.B e godet me shuplakë ne fytyrë, mirëpo nuk i shkaktojnë lëndime trupore.

- me këtë kanë kryer veprën penale **sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 47 dhe 48 të KPRK-së, si dhe neneve 495 dhe 369 të KPP-së, të pandehurit i:

GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit **A.B**, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, *i cili dënim do te jete i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Ashtu që, të pandehurës **L.M** i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, *i cili dënim do te jete i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
 - **Në të kundërtën**, nëse të pandehurit e lartcekur, brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryejnë vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me gjobë, ashtu që, do të shqiptohet dënimi për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.
- III.** Të pandehurit lirohen në tersi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.
- IV. Pala e dëmtuar:** A.Z nga fshati S., rr. "Diturija" Komuna I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën Pejë PP.II.nr.20/2023 të datës 28.02.2023, të pandehurve A.B dhe L.M, për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. ndërsa në seancën e mbajtur me datë 14.05.2024, Prokuroria ka propozuar që të pandehurve të ju shqiptohet Urdhër Ndëshkimor, dënim me gjobë. Për shkak të efikasitetit dhe ekonomizmit të procedurës si dhe meqenëse plotësohen edhe kushtet ligjore.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraparak të çështjes, konform nenit 493 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë nga provat e poshtëshënuara, të bashkangjitura në shkresat e lëndës, të cilat janë prova të pranueshme dhe të besueshme, mbi bazën e të cilave ka vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, përkatësisht nga këto provat materiale:

- Raporti i oficerit me nr. të rastit 2022-DF-676
- Deklarata e të Dëmtuarës A.Z e dhënë në st. Policor në Istog me dt.30.11.2022
- Deklarata e të pandehurës L.M e dhënë në st. Policor ne Istog me dt.30.11.2022,
- Deklarata e të pandehurit A.B e dhënë në st. Policor në Istog me dt.30.11.2022,
- Foto-dokumentacionet nga shkresat e lendes.

Gjykata duke bazuar në prova të lartcekura, vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurve, nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe se nuk ekzistojnë rrethana tjera te cilat e pengojnë ndjekjen penale.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë i shqiptuat ndaj të pandehurve siç është precizuar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve, me te cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurve me anë kushtëzimit të dënimit me gjobë i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe ju bëhet me dije se nëse kryejnë vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore te verifikimit, dënimi me gjobë i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 4 të KPP-së, i liroj të pandehurit nga shpenzimet e procedurës për faktin se të njëjtit, janë me gjendje te

dobët ekonomike, të pa punë dhe mbajtës i familjës, dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do të i' a rrezikonte gjendjen e tyre materiale dhe të anëtareve të familjes të cilët detyrohen të mbështes materialisht.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 495 dhe 369 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Sekretarja juridike,
Hale Ahmetaj

GJYQTARI,
Petrit Nrecaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij urdhër ndëshkimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në këtë gjykatë.